
PHRASEOLOGY UND PHRAZETERMS IN ALBANIAN FRAZEOLOGJIA DHE FRAZEOTERMAT NË SHQIPE

HARALLAMB MICONI

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, SHQIPËRI
miconisllambi@yahoo.gr

AKTET V, 4: 641-645, 2012

PERMBLEDHJE

Synimi i punimit tonë është të argumentojmë përse frazeotermet duhet të merren si kategori e frazeologjisë. Pasi sqarojmë se çfarë kuptojmë me njësi shumëfjalëshe të qëndrueshme dhe pasi përkufizojmë frazeologjinë si tërësi e këtyre NjSh të qëndrueshme, theksojmë se edhe NjSh të qëndrueshme emërtuese, të cilat ne i quajtmë frazeoterma, duhet të bëjnë pjesë në frazeologji. Të tilla janë: "zorrë e hollë, çelës anglez, sy magjik etj. Jo të gjithë termet shumëfjalësh që shërbejnë për të (ri)emërtuar dukuri e sende janë frazeoterma. Të tillë janë vetëm ata që përbëjnë NjSh të qëndrueshme, si p.sh. Shtëpia e Bardhë vs vaj ulliri. Kriteri kryesor i dallimit të tyre si kategori frazeologjike më vete është moskompozicionaliteti semantik, d.m.th., kuptimi tërësor i cili nuk rrjedh nga shuma e kuptimeve të përbërësve. Kriteria të tjera më specifike janë vlera denotative dhe ngurosja sintaksore. Japim gjithashtu edhe dallimet midis frazeotermave dhe njësive frazeologjike me vlerë emërore, si p.sh. sy magjik vs dulle e shpuar.

Fjale kyçe: Frazeologji, frazeoterm, moskompozicionalitet, denotacion, ekspresivitet.

Key words: Locution, phraseology, fixedness, grammatical function, equivalence

1. HYRJE

Në vitet '80 (Burger, 1982; Gréciano, 1983), të shekullit të kaluar nisën studimet për ripërcaktimin e objektit të studimit të frazeologjisë dhe të koncepteve me të cilat do të operohej. Në këtë kontekst, përcaktimi i objektit të studimit në thelb qëndron në përcaktimin e një liste kriteresh për çdo kategori me prirje për statusin frazeologjik. Deri në atë periudhë, nën ndikimin e studimeve frazeologjike ruse (Vinogradov, 1947), frazeologjia kufizohej vetëm në studimin e njësive shumëfjalëshe të ngurosura e të figurshme, me moskompozicionalitet semantik (non-compositionality, angl.; non compositionnalité, fr.), d.m.th., si tërësi kuptimore e cila nuk rrjedh nga shuma e kuptimeve të përbërësve. Me rikthimin në idenë baliane (frazeologjia me moskompozicionalitet dhe me kompozicionalitet) (Bally, 1909), filloi të

përvijohet edhe objekti i ri i studimit të frazeologjisë, ai i gjerë, si tërësi e togjeve të qëndrueshme të gjuhës (Fedoruk, 1954: 147; Stefi (Thomai), 1970: 71).

Kriter i përgjithshëm i togjeve të qëndrueshme është kufizimi leksikor, ndërsa si kriter i veçantë për pjesën më të madhe të togjeve të qëndrueshme është moskompozicionaliteti semantik. Si nënkriteria të moskompozicionalitetit janë ngurosja dhe ekspresiviteti, të cilat, të dyja së bashku a njëri prej tyre, përcaktojnë ekzistencën e kategorive të ndryshme frazeologjike me moskompozicionalitet semantik. Kështu, moskompozicionaliteti së bashku me ngurosjen morfosintaksore dhe me ekspresivitetin përbëjnë kriteret e kategorisë së njësive frazeologjike, ndërsa moskompozicionaliteti së bashku me ngurosjen sintaksore përbëjnë kriteret e kategorisë së

frazeotermave (Hausmann & Blumenthal, 2006: 4).

2. PËRKUFIZIMI I FRAZEOTERMAVE

Me frazeoterm kuptojmë një tog të qëndrueshëm emëror me vlerë denotative dhe me ngulosje sintaksore. Në literaturën gjuhësore shqiptare këto togje të qëndrueshme emërore përmenden si togfjalësha të qëndrueshëm emërorë. Në frazeoterma përfshihen si togje të qëndrueshme terminologjike, nga ku edhe emërtimi frazeoterm, ashtu edhe togje të qëndrueshme të nomenklaturës dhe të gjuhës së përgjithshme, sepse ajo që i bashkon të gjitha tipet nën ombrellën e frazeotermave është vlera e tyre emërore e denotative, si dhe ngulosja sintaksore.

3. NATYRA FRAZEOLGJIKE E FRAZEOTERMAVE

Për natyrën frazeologjike ose jo të frazeotermave, në shqipe mbizotëron mendimi se ato nuk janë njësi frazeologjike. Kështu, J. Thomai (Thomai, 1981: 74) përjashton nga frazeologjia togfjalëshat jo të figurshëm dhe vëren: “Togjet *këpucë me qafa, bombë dore, bibliotekë kombëtare* etj., që përmenden aty-këtu, si dihet, janë togje të qëndrueshme, por jo të tipit frazeologjik”, ndërsa A. Duro (Duro, 2001: 46) i quan të gjitha jofrazeologjike: “Vlen të nënvizohet se deri më sot janë dalluar si kategori të veçanta në sistemin e leksikut vetëm togfjalëshat frazeologjikë, kurse për togfjalëshat e tjerë të qëndrueshëm (jofrazeologjikë), kryesisht të tipit emëror, vetëm sa është përmendur se përbëjnë kategori më vete.”

Në bashkohemi me mendimin e J. Stefit (Thomait) (Stefi (Thomai), 1970: 71), i cili i cilëson frazeotermat si togje me natyrë frazeologjike duke i quajtur “Shprehje frazeologjike emërore që janë emërtime objektsh: *Fakulteti i Filologjisë, tensioni ndërkombëtar, luftë e ftohtë, gjendje e nderë, Ushtria e Kuqe, këpucë me qafa* etj.”, por në kategorinë frazeologjike të frazeotermave autori nuk përfshin emërtime, si p.sh., *kali i qyqes, Arusha e madhe* etj. (Thomai, 1981: 77), të cilat i përfshin vetëm në kategorinë frazeologjike të njësisë frazeologjike, gjë që do ta bënim vetëm për arsye praktike.

Hausmann & Blumenthal (Hausmann & Blumenthal, 2006: 4) i quajnë frazeotermat një nga kategoritë e frazeologjisë. Sipas tij, “Frazeologjia përbëhet nga frazeotermat (*arrêt cardiaque, équipement portuaire, feu rouge*), nga kolokacione (d.m.th., bashkëvendosje të kufizuara fjalësh me kuptime të tejdukshme (collocation, angl., fr.), shënimi im) (*administrer une gifle, un celibataire endurci, grievement blesse*) dhe nga lokucione (*casser les pieds a qqn, prendre la mouche, un cordon bleu*)”, d.m.th. njeh natyrën frazeologjike të togjeve të qëndrueshme emërore.

Edhe Granger & Paquot (Granger, 2008: 22) e njeh natyrën frazeologjike të togjeve të qëndrueshme emërore, si p.sh., *black hole*, por i quan fjalë të përbëra (compounds (angl.).

Përse frazeotermat kanë natyrë frazeologjike?

1) Frazeotermat janë frazeologjikë, sepse janë pjesë e togjeve të qëndrueshme të gjuhës që përbëjnë objektin e studimit të frazeologjisë.

2) Ata janë frazeologjikë për arsye të kompleksitetit sintaksor (i shprehur në shkallën e ngulosjes sintaksore) dhe të kompleksitetit semantik (i shprehur në mostejdukshmërinë semantike) që i afrojnë me frazemat.

4. PREJARDHJA E PËRBËRËSVE TË

FRAZEOTERMAVE

Prejardhja e përbërësve të frazeotermave në shqipe është e dyanshme: me kuptim të drejtpërdrejtë ose të figurshëm. Dallohen tre grupe:

1) Kur të dy përbërësit e frazeotermave shënojnë sende e dukuri në mënyrë të drejtpërdrejtë, si p.sh., *tru i vogël, zorrë e trashë, zorrë e hollë, pushim i gjatë, pushim i shkurtër, dërrasë e zezë, chaise longue* (fr.) (Le Nouveau, 2001: 337), *black belt* (angl.) (Oxford, 1995: 110) *μαύρη ζώνη* (gr.) (Μπαμπινιώτης, 2002: 717).

2) Kur të dy përbërësit e frazeotermave shënojnë sende e dukuri në mënyrë të figurshme, si p.sh., *nuse e lalës, kali i qyqes, sy magjik, Udha e Qumështit, Arusha e Madhe*.

3) Kur vetëm një nga përbërësit e frazeotermave shënon send e dukuri në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa tjetri i shënon në mënyrë

të figurshme, si p.sh., *natë e bardhë, Shtëpi e Bardhë, lakuriq i natës, fruta deti, pomme de terre (fr.), French window (angl.), λευκή απεργία (gr.)*.

5. Tipat e frazeotermave nga pikëpamja e prejardhjes

Në lidhje me frazeotermat vëmë re një shkallëzim të moskompozicionalitetit që lëviz nga moskompozicionaliteti i plotë në moskompozicionalitet të pjesshëm dhe një shkallëzim të figurshmërisë që lëviz nga figurshmëria e plotë në mungesën e figurshmërisë.

Mbi bazën e tipareve të moskompozicionalitetit dhe të figurshmërisë dallojmë tre tipe frazeotermash:

1) Frazeotermat me moskompozicionalitet të plotë dhe me figurshmëri, si p.sh., *sy magjik, gjuhë lope, Kashta e Kumtrit*. Karakteristikë e këtij tipi është humbja e kuptimeve transparente (...) të përbërësve dhe përdorimi i tyre në frazeoterma me kuptime jotransparente, të figurshme. Kështu, kuptimi i frazeotermi *sy magjik* nuk përfshin as kuptimin e fjalës *sy*, as kuptimin e fjalës *magjik*, por zhvillon një kuptim të ri që nuk lidhet me kuptimet të tejdukshme të përbërësve, por që lidhet me shumën e kuptimeve jo të tejdukshme që zhvillojnë të dyja fjalët, d.m.th. realizohet me moskompozicionalitet semantik.

2) Frazeotermat me moskompozicionalitet të pjesshëm dhe me figurshmëri të zbehur, si p.sh., *natë e bardhë, luftë e ftohtë, çelës anglez, porta hungareze, French window(angl.), λευκή απεργία (gr.), Shtëpi e Bardhë, White House (angl.), Kryqi i thyer*. Vetëm një fjalë hyn në përbërjen e frazeotermi me kuptim jotransparent, i cili zhvillohet vetëm në lidhje me fjalën tjetër që përdoret me kuptim transparent. Kështu, fjala *e bardhë* te frazeotermi *natë e bardhë* kuptimin e saj jotransparent *gjatë së cilës nuk flemë por rrimë zgjuar*, e zhvillon vetëm në lidhje me fjalën *natë*.

3) Frazeotermat me moskompozicionalitet të tërthortë, si p.sh., *zorrë e hollë, tru i vogël, chaise longue (fr.), flamur i bardhë, dërrasë e zezë,*

λευκή σημαία (gr.), Kryqi i Kuq, Red Cross (angl.), black belt (angl.). E veçanta e këtyre frazeotermave është që përbërësit përdoren në kuptimet e tyre transparente, por edhe sepse zhvillojnë një kuptim të shtuar, jotransparent dhe, për rrjedhojë, këta frazeoterma kanë një kuptim cilësisht të ri. Kështu kuptimi i frazeotermi *zorrë e hollë* përfshin edhe kuptimin e fjalës *zorrë*, edhe kuptimin e fjalës *e hollë*, por zhvillon edhe një kuptim të ri, që është *“organ i qenieve të gjalla me një funksion të caktuar”*.

6. Kriteret e frazeotermave

- Moskompozicionaliteti semantik;
- Ngurosjë vetëm sintaksore dhe mungesa e ngurosjes morfologjike;
- Vlera ekskluzivisht denotative dhe mungesa e ekspresivitetit.

Frazeotermat përbëjnë një kategori të veçantë frazemash, sepse shërbejnë për të emërtuar objekte e dukuri të reja ose për të riemërtuar disa ekzistuese dhe jo për të vlerësuar a për të cilësuar qenie, objekte e dukuri të realitetit.

Ajo që i bën frazeotermat të kenë natyrë frazeologjike është moskompozicionaliteti semantik, ndërkaq, ajo që i bën të përfshihen në një kategori më vete janë vlera denotative dhe ngurosjë sintaksore.

7. Tiparet e frazeotermave

- Shumëfjalësia (dy e më shumë fjalë të ndara grafikisht);
- Qëndrueshmëria;
- Dy fjalë shënuese;
- Moskompozicionaliteti semantik;
- Vlera denotative dhe mungesa e ekspresivitetit;
- Ngurosjë sintaksore dhe mungesa e ngurosjes morfologjike;
- Funksioni emërtues;
- Figurshmëria për një pjesë të tyre;
- Nominaliteti;
- Njësi të gatshme leksikore;
- Mungesa e sinonimisë me njësi njëfjalëshe për shumicën prej tyre.

8. Kategoritë përbërëse të frazeotermave

Në përbërjen e frazeotermave hyjnë tri kategori togjesh të qëndrueshme:

1) Togje të qëndrueshme terminologjike a të gjuhëve të specializuara, si p.sh., *kokë blloku*, *bosht me bërriyla*, *zorra e hollë*, *çelës anglez*, *cle anglaise (fr.)* etj.

2) Togje të qëndrueshme të nomenklaturës, si p.sh., *pallat kulture*, *shtëpi kulture*, *shtëpi e lindjes*, *Shtëpi e Bardhë*, *White House (angl.)*, *Mali i Zi*, *Deti i Zi*, *Black Sea (angl)*, *La Mer Noire (fr.)* etj.

3) Togje të qëndrueshme të gjuhës së përgjithshme, si p.sh., *tel me gjemba*, *sy magjik*, *natë e bardhë*, *chaise longue (fr.)* *disc jockey (angl.)* etj.

A janë të gjitha këto njësi shumëfjalëshe të gjuhëve të specializuara, të nomenklaturës dhe të gjuhës së përgjithshme togje të qëndrueshme?

Jo. Ato që janë togje të qëndrueshme do t'i quajmë frazeoterma. Të tjerat janë togje të lira dhe nuk përbëjnë objekt studimi të frazeologjisë. Të tilla janë: *kënd i ngushtë*, *kënd i gjerë* (Duro, 2001: 50); *bibliotekë kombëtare*, *Fakulteti i Filologjisë* (Stefi (Thomai), 1970: 72); *ve pate*, *bukë gruri* (Cipo, 1949), të cilat janë togje të lira (grupi i parë i gjuhëve të specializuara, d.m.th. terminologjike, grupi i dytë i gjuhës së nomenklaturës, grupi i tretë i gjuhës së përgjithshme, dhe të gjitha së bashku janë të fushës emërore), sepse nuk zhvillojnë kuptime jontransparente dhe nuk kanë mostejdukshmëri semantike, dhe, për rrjedhojë, përbërësit mund të përdoren edhe në lidhje të pakufizuara.

Kufiri midis frazeotermave dhe togjeve të lira emërore nuk është as i prerë, as i lehtë për t'u vendosur. Kjo varet nga lloji i fjalorit dhe nga shkalla e njohjes së folësve të gjuhës.

9. Dallimet midis frazeotermave dhe njërive frazeologjike me vlerë emërore

Për sa u përket dallimeve, më kryesoret janë dy: njëri lidhet me ekspresivitetin dhe tjetri me ngulosjen.

1) Në nivel funksional, frazeoterma janë njësi ekskluzivisht denotative, ndërsa njësitë frazeologjike me vlerë emërore janë njësi

kryesisht ekspresive, me vlerë stilistikore dhe emocionale.

Frazeotermat shërbejnë për të emërtuar sende e dukuri të reja ose për të riemërtuar disa ekzistuese, pasqyrojnë lidhjet ndërmjet objekteve të realitetit objektiv, ose të objekteve dhe të vetive të tyre (Duro, 2001: 45), ndërsa njësitë frazeologjike emërore shërbejnë kryesisht për të vlerësuar dikë apo diçka, d.m.th. shënojnë cilësi të qenieve a të sendeve (Thomai, 1981: 76).

2) Në nivel formal, njësitë frazeologjike me vlerë emërore nuk kanë paradigme të plotë, ndërsa përbërësit e frazeotermave nuk paraqesin bllokim a ngulosje të kategorive morfologjike. Kështu, frazeoterma *sy magjik* mund të përdoret në të dy numrat, në të dyja trajtat dhe në të gjitha rasat: *Administratori porositi tre sy magjikë për dyert e pallatit të ri*; *Syri magjik që i propozoi shitësi ishte i një cilësie shumë të mirë*; *Nesër do të vijë ustai për vendosjen e syrit magjik*.

Ajo çka është e ngulosur në një shkallë të madhe te frazeotermat, është lidhja midis përcaktuesit dhe bazës (të përcaktuarit), gjë që e bën njësinë të përdoret si një e tërë dhe e pandarë. P.sh., nuk duhet thënë: *Kryeqytetasit festuan natën më të bardhë dhe më të bukur të dhjetëvjeçarit*, por: *Kryeqytetasit festuan natën e bardhë më të bukur të dhjetëvjeçarit*.

Ndërsa frazeotermat paraqesin vetëm ngulosjeje sintaksore, njësitë frazeologjike emërore, përveç ngulosjes sintaksore, kanë në një farë mase edhe ngulosje morfologjike, e cila duket në përdorimin e kufizuar morfologjik të njërive frazeologjike emërore, si: *Daulle e shpuar dhe jo një daulle e shpuar*, *dy daulle të shpuara*; *Ëndrra në diell dhe jo ëndërr në diell*, *një ëndërr në diell*, *ca ëndrra në diell*, *dy ëndrra në diell* etj.; *Shesh me lule dhe jo një shesh me lule*, *sheshe me lule*, *disa sheshe me lule* etj.

10. Dallime të tjera (të pjeshme):

10.1. Figurshmëria

Vetëm një pjesë e frazeotermave kanë prejardhje të figurshme, si p.sh., *sy magjik*, *nuse e lalës*, *Udha e Qumështit* etj., ndërkohë që njësitë frazeologjike janë të gjitha të figurshme nga prejardhja. Kjo bën që figurshmëria të jetë tipar i

përgjithshëm i njësive frazeologjike dhe tipar i veçantë për një pjesë së frazeotermave, por jo kriter dallues midis tyre.

10.2. Korrespondimi sinonimik

Përgjithësisht njësitë frazeologjike bashkëjetojnë me fjalët sinonime, ndërsa frazeotermat përgjithësisht nuk kanë njësi njëfjalëshe sinonime korresponduese.

11. Rëndësia e frazeotermave

Duke shënuar nëpërmjet lidhjeve të qëndrueshme të gjymtyrëve të tyre objekte ose dukuri të veçanta të realitetit, frazeotermat paraqiten si një mjet i efektshëm me një lehtësi të madhe formimi për plotësimin e nevojave a të boshllëqeve të gjuhës.

Frazeotermat përbëjnë një mënyrë ekonomike për emërtimin e sendeve dhe të dukurive të reja të realitetit objektiv kundrejt perifrastave a fjalëve të reja.

Frazeotermat pasurojnë leksikun me njësi të reja, krahas mjeteve të tjera fjalëformuese (si prejardhja, përbërja, përngjitja etj.).

Duke qenë njëkuptimësh, frazeotermat janë të përshtatshëm për natyrën rigoroze të fjalorit terminologjik.

12. Konkluzione

Në këtë punim u përpoqëm t'u përgjigjemi disa pyetjeve si:

Cila është natyra e frazeotermave: frazeologjike. Cili është statusi i frazeotermave në lidhje me njësitë frazeologjike me vlerë emërore: vlera denotative dhe mungesa e ekspresivitetit.

BIBLIOGRAFIA

- BALLY, Ch. (1909). *Traité de stylistique française*. Paris: Klincksieck.
- BURGER, H., BUHOFER, A., SIALM, A., (1982). *Handbuch der Phraseologie*, Berlin.
- CIPO, K. (1949). *Gramatika shqipe*. Tiranë.
- DURO, A. (2001). *Terminologjia si sistem*. Panteon, Tiranë
- FEDORUK, G. (1954). *Sovremjennij Ruskij Jazyk. Leksika*. Moskva.
- GRANGER, S. & PAQUOT, M. (2008). 'Disentangling the phraseological web'. In: GRANGER, S. & MEUNIER, F. *Phraseology -An interdisciplinary perspective*. John Benjamins Publishing Company, Amsterdam / Philadelphia.
- GRÉCIANO, G. (1983). 'Signification et dénotation en allemand': *La sémantique des expressions idiomatiques*. Klincksieck, Paris.
- HAUSMANN, F.J. & BLUMENTHAL, P. (2006). 'Presentation: collocations, corpus, dictionaries': *Langue française*. Tübingen: Niemeyer.
- LE NOUVEAU Petit Robert (2001). *Dictionnaires Le Robert*, Paris.
- OXFORD ADVANCED Learner's Dictionary of Current English (1995), Oxford University Press.
- STEFI (THOMAI), J. (1970). *Leksikologjia shqipe*, Tiranë, 1961.
- THOMAI, J. (1981). *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.
- VINOGRADOV, V. V. (1947). 'Ob osnovnyx tipach frazeologičeskix edijic v sovremennom ruskom jazyke': V. V. Vinogradov, *Izbrannyje trudy: leksikologjia i leksikografija*. Moskva: Nauka.
- ΜΠΑΜΠΙΝΙΩΤΗΣ, Γ. (2002). *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*. Κέντρο λεξικολογίας, Αθήνα..